



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Pyjeve Bujqësisë Menaxhimit të Ujërave Turizmit dhe
Mbrojtjes së Mjedisit



Fushë-Arrëz, më 25.03.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 9 datë 10/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Planit të Masave për Parandalimin dhe Shuarjen e Zjarreve në Pyje dhe Kullota për vitin 2025 në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz"

Analiza ligjore: Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015" Për Vetëqeverisjen Vendore: Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni pika.4, shkronja.c; ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi": VKM-ne nr. 134 d 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 date 08.06.2016 të këshillit të ministrave " transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" të ndryshuar, si dhe referuar Shkreses Nr.7 Prot datë 07.03.2024 "Dërgim për miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrëve në pyje dhe kullota për vitin 2025" nga DAPK, Sektori Emergjencave Civile dhe MZSH,

Situata aktuale e funksionit: Përmes Planit të masave në këtë program buxhetor, synohet që bashkia të sigurojë përdorim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit 2024 dhe do të vazhdojë gjatë 2025 me objektiva si: Përmirësimi i shërbimit pyjor dhe kullosor

Situata financiare: Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është ai miratuar në buxhetin e vitit 2025.

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Bujqësisë, pyjeve dhe kullotave e ka relatuar përpara komisionit.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Pyjeve Bujqësisë Menaxhimit të Ujërave Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Financës ose Drejtorinë e Bujqësisë, pyjeve dhe kullotave për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Plani impakton jetën të gjitha shtresave që lidhen me pyjet dhe kullotat, kategorive dhe grupeve të interesit dhe zhvillimin e të gjithë territorit të Bashkisë.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimeve me publikun.

Komisioni i Pyjeve Bujqësisë Menaxhimit të Ujërave Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i mbledhur me datën 25/03/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 9 datë 10/03/2025, relacionet e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Planit të Masave për Parandalimin dhe Shuarjen e Zjarreve në Pyje dhe Kullota për vitin 2025 në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për shqyrtim vlerësim të mëtejshëm.
 - b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin/relacionin e mbledhjes së Komisionit

Mustaf Pashkaj
(emri, mbiemri, firma)



Kryetar i Komisionit

Pavlin Qafa
(emri, mbiemri, firma)



Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONIT TË BUJQËSISE, PYJEVE, MENAXHIMIT TË UJRAVE, TURIZMIT,
MBROJTJES SË MJEDISIT

Nr. 884



Fushë-Arrëz, më 25. 03. 2025

PER : KESHILLIN E BASHKISE

FUSHË-ARRËZ

Relacion i Komisionit të Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit mbi Projektvendimin për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025, në territorin administrativ të bashkisë Fushë-Arrëz.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", i ndryshuar, u mbledh Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit (Mustaf Pashkaj, Nikolin Sadikaj, Pavlin Qafa) ditën e marte, datë 25. 03. 2025, ora 10:30, në sallën e mbledhjeve të Këshillit me pjesëmarrjen e Mustaf Pashkaj e Pavlin Qafa ku u mor ne shqyrtim Projektvendimi lidhur me planin e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025, në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Ne mbledhje për shpjegimin e projektvendimit ishte z. Sokol Vata, Perfaqesues i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave:

Në kuader të marrjes së masave për parandalimin e rënies së zjarrëve në pyje dhe kullota në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për vitin 2025 hartoj planin e masave paraprahe për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret në bashkëpunim me sektorin e Emergjencave Civile dhe M.Z.SH si më poshtë:

1. Organizimi i takimeve me banoret e të gjithë Njësive Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz për domosdoshmërinë e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret (Mars - Prill 2025).
2. Perpilimin dhe shpërndarjen për çdo Nj. Administrative dhe fshat të formularëve të skuadrave të M.Z.SH-së, instruktimin e këtyre skuadrave të zjarrëfiksëve të fshatit (Mars-15 Maj 2025).
3. Organizimi i mbledhjeve nga Kryetarët e fshatërave me të gjithë banorët, krijimi i skuadrave zjarrfikse dhe vrojtuese dhe vrojtuesëve ditor të fshatërave (deri në 15 Prill 2025).

4. Krijimi i skuadrave zjarrëfikse, sjellja e listave me emrat e skuadrave pranë Seksionit të Pyjeve për secilin fshat (deri në 15 Maj 2025).
5. Evidentimi dhe mbajtja në vezhë të përhershëm të zonave të rrezikuara me rrezikshmëri të lartë për zjarre (Maj 2025 e në vazhdim).
6. Njoftimi në kohë të shpejte e rënjes së zjarrit dhe marrja në kohë e masave për izolimin e tij (gjatë gjithë kohës).
7. Përpilimi i dokumentacionit të nevojshëm për zjarret, dhënia e menjëhershme e informacioneve organeve përgjegjëse (vazhdimisht).
8. Për parandalimin e zjarrëve në pyje do të bashkëpunohet me të gjithë aktorët privat dhe shtetëror që operojnë në Bashkinë e Fushë-Arrëz (vazhdimisht).
9. Në çdo rast nevojë do të kërkohej edhe ndihma e të gjithë institucioneve të Qendrave Shëndetësore dhe Arsimore që janë në territorin e Bashkisë (vazhdimisht).
10. Do të bashkëpunohet ngushtë me median lokale e kombëtare, vizive dhe të shkruar për ndërgjegjësimin e komunitetit për parandalimin e zjarrëve në pyje (Korrik 2025).
11. Do të përdorim Togëfjalshin "MBRONI PYJET NGA ZJARRET" dhe "PYJET JANE PASURI E JONË" si mbishkrime në vende të dukshme për sensibilizimin e komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret.

Sokol Vata, Përfaqësues i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, kërkon komisionit që ta miratojmë projektin dhe t'a kalojmë për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të keshillit bashkiak të datës 26.03.2025

Pavlin Qafa, anëtar i komisionit thotë që unë jam dakord me projektin.

Mustaf Pashkaj ve theksin në korrektesinë e zbatimit të këtij projekti.

Komisionerët ranë dakord me **shumicë votash** duke e dërguar projektin për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e datës 26.03.2025

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

PER KOMISIONIN

Pavlin QAFA



Mustaf PASHKAJ

